



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 337/5 Prot.

Tiranë, më 28.01 .2025

V E N D I M

Nr. 14 dt. 28.01 2025

“PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE PROFILIZUESE DERI NË MASËN 20% TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR NË “SHKENCAT E REHABILITIMIT”, TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË REHABILITIMIT”

Mbështetur në nenin 3 pika 2 gërma b, 35, 37, 38 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Udhëzimin e MASR nr.1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, në nenin 7 pika 2 gërma b, nenin 19, nenin 20 të Statutit të UST-së, në nenin 7, 48, 52 dhe 53 të Rregullores së UST-së, shkresës nr. 3215/5 Prot., datë 27.01.2025 “Propozim për ndryshime profilizuese deri në masën 20% të programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Shkencat e Rehabilitimit” ofruar nga FSHR, për vitin akademik 2025-2026”, Vendimit të Rektoratit nr.19, datë 27.01.2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës 28.01.2025,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve profilizuese në masën 20%, në programin e ciklit të parë të studimit “Bachelor në “Shkencat e Rehabilitimit”, ofruar nga Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit duke filluar nga viti akademik 2025-2026
2. Miratimin e Planit Mësimor të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkencat e Rehabilitimit”, bashkëlidhur këtij Vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Humane, si dhe i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA



